



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 17.10.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR ZOGAJ (REPUBLIKA E SHQIPËRISË) – SKJE (MALI I ZI) PËR QARKULLIMIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR DHE TË PASAGJERËVE NË LIQENIN E SHKODRËS”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës”, në mbledhjen e datës 17 tetor 2018.

Të pranishëm në mbledhje ishin përfaqësues të Ministrisë së Brendshme.

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës, në kuadër të lehtësimit të qarkullimit në pikën e përbashkët kufitare.

Pika e kalimit kufitar Zogaj është një pikë e përbashkët e kalimit kufitar në Bashkinë e Shkodrës, në kufirin me Malin e Zi, e cila ndodhet 11 km në veriperëndim të qytetit të Shkodrës, në bregun e liqenit të Shkodrës. Kjo pikë do të jetë e hapur 24 orë në ditë për qarkullim ndërkombëtar rrugor dhe qarkullim të personave në liqenin e Shkodrës.

Nga kjo marrëveshje mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, pritët që:

- të lehtësohet lëvizja e banorëve të zonave afër Bashkisë së Shkodrës dhe zonave të Malësisë së Krajës, komuna e Tivarit - Mali i Zi, në të dyja anët e kufirit,
- të shkurtohet distanca mes zonave;

- të reduktohet fluksi i kalimit në pikën e kalimit doganor të Murriqanit gjë e cila do ishte shumë lehtësuese gjatë sezonit turistik;
- të ketë kontroll më të mirë të kufirit në zonën e Zogajt;
- të kontrollohet bregut i liqenit të Shkodrës, si dhe
- të shfrytëzohen vlerat turistike të liqenit të Shkodrës dhe traditat e banorëve të Malësisë së Tivarit.

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të kryhet nga Komisioni i Përbashkët i Ekspertëve, i cili ka shërbyer edhe për hapjen e pikës së përbashkët kufitare Muriqan-Sukobin.

Kostot financiare të parashikuara në marrëveshje do të përballohen nga programi buxhetor “Policia e Shtetit”.

Deputetët vlerësuan efektin pozitiv që pritet të ketë kjo pikë e re doganore në lehtësimin e lëvizjes së banorëve, sidomos në sezonin turistik dhe në promovimin e shfrytëzimin e vlerave turistike të liqenit dhe zonave përreth tij.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm në mbledhje.

Besnik BARAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar